



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Drzavnog Tuzioca / Office
of the Chief State Prosecutor

A.nr.150/2021

Datë: 20 maj 2021

Prishtinë

Kryeprokurori i Shtetit, në pajtim me nenin 1 lidhur me nenin 11 par.1 pikat 1.1 dhe 1.5 të Ligjit nr.05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, si dhe në pajtim me nenin 28 par.6 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ligji nr.06/L-056, merr si në vijim këtë:

V E N D I M

1.Znj.Mone Syla,prokuror i shtetit në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, **transferohet përkohësisht** në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Gjakovë.

2.Znj.Syla,do të transferohet në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, për një periudhë kohore prej 6(gjashtë)muajve dhe atë që nga dt. 24 maj 2021.

3.Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit-Kryeprokurori i Shtetit,më dt.18 maj 2021,nga U.D.Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjakovë, z.Ali Uka, përmes postës elektronike-email-it zyrtar,ka pranuar një parashtresë-kërkesë për 1(një) prokuror të shtetit në kuadër të Departamentit për të Mitur të asaj prokurorie.

U.D.Kryeprokurori i asaj prokurorie në fjalë, këtë kërkesë e ka mbështetur në faktin se meqë në kuadër të Departamentit për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Gjakovë i vetmi prokuror i shtetit i atij Departamenti z.Ismet Tofaj, kishte dalur në pension që nga dt.03 maj 2021,ndërkaq ky Departament për të Mitur, ka mbetur pa asnjë prokuror të shtetit që do të i trajtonte lëndët penale për të mitur të cilat janë të natyrës specifike e me qëllim të funksionimit sa më efikas të atij Departamenti, transferimi-angazhimi i një prokurori të shtetit është i natyrës urgjente.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të hollësishëm të atyre pretendimeve të U.D.Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, z. Ali Uka, të parashtruara në të njëjtën kërkesë të sipër cekur, fakte këto që janë të natyrës prioritare e në funksion të ngritjes së efikasitetit rreth trajtimit-procedimit të atyre çështjeve penale që i referohen kategorisë së personave të mitur, kam konsideruar se transferimi i përkohshëm i znj. Syla i përmbush nevojat e natyrës urgjente për trajtimin e lëndëve penale për të mitur ashtu si është kërkuar nga ana e U.D.Kryeprokurorit të asaj prokurorie në fjalë.

Për çështjen e transferimit të përkohshëm të znj. Syla, nga Departamenti i Përgjithshëm i asaj prokurorie në Departamentin për të Mitur të asaj prokurorie, ashtu si ka potencuar U.D.Kryeprokurori i asaj prokurorie në fjalë në kërkesen e sipër cekur, se e njëjta prokurorie e shtetit, kishte shprehur interesimin e saj për një transferim të tillë.

Andaj, në bazë të gjitha këtyre të sipër cekurave u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryeprokurori i Shtetit
Aleksandër Lumezi



Vendimi i dërgohet:

- Z. Ali Uka, U.D.Kryeprokurori i PTH-Gjakovë
- Znj. Mone Syla, prokuror i shtetit në PTH-Gjakovë
- Arkivit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit
- NJSHPP-së
- Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve